

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaWrap®-300 C

PËLHURË FIBRASH KARBONI ME THURJE NJË DREJTIMI, E DIZEJNUAR PËR APLIKIME PËRFORCIMI TË STRUKTURAVE SI PJESË E SISTEMIT PËRFORCUES SIKA®.

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaWrap®-300 C është pëlhurë e thurur në një drejtim me fibër karboni të rezistencës mesatare, e dizenuar për instalim duke përdorur proces aplikimi të thatë ose të lagësht.

PËRDORIMET

SikaWrap®-300 C duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Përforcim strukturor i betonit të armuar, mureve, mureve me tulla dhe elementeve apo strukturave prej druri, për rritje të aftësisë bartëse në përkulje dhe gërrshërim (shkarje) për:

- Performancë e përmirësuar sizmike e mureve
- Zëvendësim të armaturës së munguar prej çeliku
- Rritje të fuqisë dhe duktilitetit të kolonave
- Rritje të kapacitetit bartës të elementeve strukturore
- Mundësi ndryshimesh në përdorim / alternimesh dhe rinovimesh
- Korrigjim të defekteve në dizajnin e strukturës dhe / ose të ndërtimit
- Rritje të rezistencës ndaj lëvizjeve sizmike
- Përmirësim të jetëgjatësisë së shërbimit dhe qëndrueshmërinë
- Përmirësim strukturor në përputhje me standardet aktuale

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Pëlhurë multifunkionale për përdorim në aplikime të ndryshme përforcimi
- Fleksibël dhe e përshtatshme për sipërfaqe me plan dhe gjeometri të ndryshme (trarë, kolona, oxhaqe, shtylla, mure, silose, etj.)
- Dendësi e ulët për peshë shtesë minimale
- Me kosto tepër efikase në krahasim me teknikat tradicionale të përforcimit

MIRATIME / STANDARDE

- Poloni: Technical Approval ITB AT-15-5604/2011: Zestaw wyrobów Sika CarboDur do wzmocnienia i napraw konstrukcji betonowych
- Poloni: Technical Approval IBDiM Nr AT/2008-03-0336/1 „Płaskownicy. pręty, kształtki i maty kompozytowe do wzmocnienia betonu o nazwie handlowej: Zestaw materiałów Sika CarboDur® do wzmocnienia konstrukcji obiektów mostowych
- USA: ACI 440.2R-08, Guide for the Design and construction of Externally Bonded FRP Systems for strengthening concrete structures, July 2008
- UK: Concrete Society Technical Report No. 55, Design guidance for strengthening concrete structures using fibre composite material, 2012.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ndërtimi	Orientimi i fibërës	0° (njëdrejtimi)
		Baza
	Fija	Fibra të bardha termoplastike të përpunuara me metodën e nxehtë 1%
Lloji i fibrës	Fibra të përzgjedhura karboni me rezistencë mesatare	

Ambalazhi	Gjatësi pëlhure për rulon	Gjerësi pëlhure
10 rulona në kuti kartoni	≥ 50 m	100 mm
4 rulona në kuti kartoni	≥ 50 m	300 mm
2 rulona në kuti kartoni	≥ 50 m	600 mm
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia e fibrave të thata	1.82 g/cm ³	
Trashësia e fibrave të thata	0.167 mm (bazuar në përmbajtjen e fibrës)	
Dendësia e sipërfaqes	304 g/m ² ±10 g/m ² (vetëm fibrat e karbonit)	
Rezistenca e fibrave të thata ndaj tërheqjes	4 000 N/mm ²	(ISO 10618)
Moduli i elasticitetit i fibrave të thata në tërheqje	230 000 N/mm ²	(ISO 10618)
Zgjatimi deri në thyerje i fibrave të thata	1.7 %	(ISO 10618)

TË DHËNA TEKNIKE

Trashësia nominale e fletës	0.167 mm		
Prerja tërthore nominale e fletës	167 mm ² për m gjerësie		
Rezistenca e fletës ndaj tërheqjes	Mesatare	Karakteristike	(EN 2561*)
	3 500 N/mm ²	3 200 kN/mm ²	(ASTM D 3039*)
Moduli i elasticitetit i fletëve në tërheqje	Mesatar	Karakteristik	(EN 2561*)
	225 kN/mm ²	220 kN/mm ²	
	Mesatar	Karakteristik	(ASTM D 3039*)
	220 kN/mm ²	210 kN/mm ²	
* mostër e modifikuar me 50 mm Vlerat në drejtimin gjatësor të fibrave Shtresë e vetme, min. 27 mostra për seri testimesh			
Zgjatimi deri në thyerje i fletëve	1.56 %		(bazuar në EN 2561)
	1.59 %		(bazuar në ASTM D 3039)
Rezistenca ndaj tërheqjes	Mesatare	Karakteristike	(bazuar në EN 2561)
	585 N/mm	534 N/mm	(bazuar në ASTM D 3039)
Ngurtësi elastike	Mesatare	Karakteristike	(bazuar në EN 2561)
	37.6 MN/m	36.7 MN/m	
	37.6 kN/m për ‰ zgjatim	36.7 kN/m për ‰ zgjatim	
	Mesatare	Karakteristike	(bazuar në ASTM D 3039)
	36.7 MN/m	35.1 MN/m	
	36.7 kN/m për ‰ zgjatim	35.1 kN/m për ‰ zgjatim	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Ndërtimi dhe konfigurimi i sistemit duhet të zbatohet plotësisht siç përshkruhet dhe nuk duhet ndryshuar.

Prajmeri për ndërkapjen me nënshtresën e betonit Sikadur®-330

Rrëshira për impregnim / ngjitje Sikadur®-330 ose Sikadur®-300

Pëlhura për përforcimin e strukturës SikaWrap®-300 C

Për informacione të detajuara rreth Sikadur®-330 ose Sikadur®-300, së bashku me detajet e aplikimit të rrëshirës dhe pëlhurës, ju lutemi referohuni tek skeda teknike e Sikadur®-330 ose Sikadur®-300 dhe tek Method Statement përkatëse.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi

Aplikim i thatë me Sikadur®-330

Shtresa e parë përfshirë shtresën e prajmerit 1.0–1.5 kg/m²

Shtresat vijuese 0.8 kg/m²

Aplikim i lagësht me Sikadur®-300, prajmer Sikadur®-330

Shtresa e prajmerit 0.4–0.6 kg/m²

Shtresat e pëlhurës 0.6 kg/m²

Ju lutemi referohuni gjithashtu tek Method Statement përkatëse për informacione të mëtejshme.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Rezistenca minimale ndaj tërheqjes e nënshtresës: 1.0 N/mm² ose siç specifikohet në dizajnin e përforcimit. Ju lutemi referohuni gjithashtu edhe tek Method Statement përkatëse për informacione të mëtejshme.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Betoni duhet të pastrohet dhe përgatitet për të arritur një sipërfaqe pa kore çimentoje dhe kontaminime dhe me teksturë të hapur.

Ju lutemi referohuni gjithashtu edhe tek Method Statement për informacione të mëtejshme.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Pëlhura mund të pritët me gërshërë të posaçme ose me thikë Stanley (bìçak profesional / thikë për të prerë kutitë). Kurrë mos e përthyeri/ palosni pëlhurën. SikaWrap®-300 C aplikohet me procesin e aplikimit të thatë ose të njomë.

Ju lutemi referohuni tek Method Statement për detaje rreth procedurës së impregnimit / ngjitjes.

DOKUMENTA SHITESË

Method Statements

Ref. 850 41 02: SikaWrap® aplikim manual me metodën e thatë

Ref. 850 41 03: SikaWrap® aplikim manual me metodën e lagësht

Ref. 850 41 04: SikaWrap® aplikim manual me

metodën e lagësht

KUFIZIME

- SikaWrap®-300 C duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë dhe të trajnuar.
- Duhet të këshilloheni me një inxhinier strukturash specialist për çdo përllogaritje të dizajnit të përforcimit të strukturës.
- Pëlhura SikaWrap®-300 C vishet me rrëshirën Sikadur® për ngjitje / impregnim / shtrim për të siguruar ngjitje dhe qëndrueshmëri maksimale. Që të ruhet dhe sigurohet një pajtueshmëri e plotë e sistemit, mos ndërroni përbërësit e ndryshëm të sistemit.
- SikaWrap®-300 C mund të mbivishet me një mbulesë çimentoje ose veshje të tjera për qëllime estetike dhe / ose mbrojtëse. Përzgjedhja e sistemit të mbiveshjes varet nga ekspozimi dhe kërkesat specifike të projektit. Për mbrojtje shtesë kundër rrezeve UV në zonat e ekspozuara përdorni Sikagard®-550 W Elastic, Sikagard® ElastoColor-675 W ose Sikagard®-680 S.
- Ju lutemi referohuni tek Method Statement të SikaWrap® për metodë manuale aplikimi të thatë (Ref. 850 41 02), SikaWrap® me metodë manuale aplikimi të thatë (Ref. 850 41 03) ose SikaWrap® me metodë aplikimi të lagësht me makineri (Ref. 850 41 04) për informacione, udhëzime dhe kufizime të mëtejshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

RRÉGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaWrap®-300 C
Qershor 2019, Botimi 01.01
020206020010000011

SikaWrap-300C-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf

